



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE
TË AGJENCISË SË SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR
PËR VITIN 2021**

Prishtinë, maj 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Në katër pagesa në vlerë prej 112,622€ kishte keq klasifikim të shpenzimeve, pasi që nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ishin paguar shpenzime që sipas natyrës i takonin kategorisë së investimeve kapitale si dhe pagave dhe mëditjeve.
- A2 Vlera e detyrimeve të pa paguara në PFV ishte nënvlerësuar për 178,702€, për shkak se nuk ishin shpalosur si obligime të cilat i takojnë vitit 2021.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

B1 Në nëntë pagesa në vlerë 355,942€ kishte vonesë në pagesën e faturave përtej afatit ligjor prej 30 ditësh. Vonesat ishin nga shtatë ditë deri një vit.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Kjo ka për qëllim të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do të përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me katër rekomandime, prej tyre tri janë rekomandime të reja dhe një i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Keq klasifikim i shpenzimeve

Gjetja	<p>Sipas nenit 18 pika 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013 MF Shpenzimi i parasë publike - shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ (UA) 19/2009 për planin kontabël.</p> <p>Në katër pagesa në vlerë prej 112,622€ , shpenzime që sipas natyrës i takonin kategorisë së pagave dhe mëditjeve dhe investimeve kapitale ishin paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Një nga pagesat ishte ekzekutuar nga Thesari dhe kishte të bënte me kompensim të pagave dhe përfitimeve tjera për punonjësit, derisa tri pagesat e tjera ishin ekzekutuar përmes vendimeve gjyqësore dhe kishin të bënin kryesisht me kompensime të dëmeve për parcela/tokë.</p> <p>Kjo kishte ndodhur për shkak se në kategoritë përkatëse nuk kishin mjete të mjaftueshme për ekzekutimin e këtyre pagesave.</p>
Ndikimi	<p>Pagesa e shpenzimeve nga kategoria ekonomike jo adekuate vështirëson realizimin e buxhetit sipas planifikimeve dhe ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve duke reflektuar kështu në prezantimin jo të drejtë të tyre në PFV.</p>
Rekomandimi A1	<p>Drejtori duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestini i mjeteve dhe që realizimi i pagesave të bëhet në kategorinë adekuate për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV, në përputhje me planin kontabël.</p>
Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)	

Çështja A2 - Mos prezentimi i detyrimeve në PFV

- Gjetja** Sipas Rregullores së MF. Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore, nenit 17, pika 3 kërkon që organizatat buxhetore duhet të raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues.
- Gjatë testimit të shpalosjeve për detyrimet e papaguara, ne kemi vërejtur se gjashtë fatura në vlerë 178,702€ të cilat i takojnë vitit 2021, nuk ishin paraqitur apo shpalosur në pasqyra vjetore financiare si detyrime të papaguara.
- Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve të brendshme me rastin e prezantimit apo shpalosjes së detyrimeve në PFV.
- Ndikimi** Mosparaqitja e saktë e vlerës së detyrimeve të papaguara në PFV ndikon në nënvlerësimin dhe prezantimin e informatave jo të sakta për shfrytëzuesit e PFV-ve.
- Rekomandimi A2** Drejtori duhet të sigurojë kontrolle efektive në regjistrimin dhe paraqitjen e saktë të vlerës së detyrimeve, sipas kërkesës së rregullores për raportim financiar, në mënyrë që të mundësohet raportim i saktë i tyre në PFV

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B1 - Vonesë në pagesën e obligimeve

Gjetja Rregulla Financiare 01/2013 MF për shpenzimin e parasë publike, neni 37, pika 1, përcakton se të gjitha faturat që i pranon organizata buxhetore duhet të paguhen brenda 30 ditëve në qoftë se nuk është paraparë ndryshe me kontratë.

Në nëntë pagesa në vlerë 355,942€, kemi vërejtur që faturat e pranuar nuk ishin paguar me kohë. Vonesat ishin nga shtatë ditë deri një vit, pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditësh.

Edhe këtë vit kishte vonesa në pagesa për shkak të mungesës së mjeteve në kategorinë e investimeve kapitale në momentin e pranimit të faturave.

Ndikimi Tejkalimi i afatit ligjor për pagesën e obligimeve mund ta bëjë ASHNA-në subjekt të padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbartimore apo obligime për vitin vijues.

Rekomandimi B1 Drejtori duhet të siguroj funksionimin efikas të pikës së kontrollit të pagesave që verifikon se faturat bëhen në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me ligj.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 6,133,148€, pasurive jokapitale është 96,112€, si dhe e stoqeve 14,883€. Kemi testuar 25 mostra në vlerë 5,030,621€ për teste substanciale dhe teste të pajtueshmërisë.

Çështja A3 - Mos zhvlerësimi i pasurisë nën 1000€

Gjetja

Rregulla MF-02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizata buxhetore, neni 22, pika 1, specifikon se, të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit.

Pasuria jokapitale nën 1,000€ e cila ishte prezantuar në PFV-të e ASHNA, nuk paraqet vlerën reale për shkak se nuk ishte përllogaritur zhvlerësimi i vitit por vlera e pasurisë ishte paraqitur në vlerën bruto.

Kjo kishte ndodhur për shkak se zyrtari i pasurisë nuk kishte përllogaritur manualisht zhvlerësimin derisa sistemi e-pasuria nuk ishte funksional.

Ndikimi

Prezantimi i vlerës së pasurive duke mos përllogaritur vlerën e zhvlerësimit ndikon në mbi deklarim të pasurive në PFV.

Rekomandimi A3

Drejtori duhet të sigurojë se në PFV vlera e pasurisë nën 1,000€ prezantohet në bazë të vlerës kontabël neto për të mundësuar raportim të drejtë dhe të saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	5,907,467	5,448,318	5,402,833	5,425,954	6,295,234
Grante Qeveritare - Buxheti	1,632,550	1,172,203	1,172,103	2,202,644	1,442,737
Te hyrat e dedikuara	4,274,917	4,276,114	4,230,730	3,223,310	4,458,847
Te hyrat nga AKP-ja	0	0	0	0	393,650

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 459,149€. Ky zvogëlim apo ndryshim i buxhetit është rezultat i vendimeve të qeverisë.

Në vitin 2021 ASHNA ka shpenzuar 99% të buxhetit përfundimtar në 2021 ose 5,402,833€, me një përmirësim prej 32% në krahasim me vitin 2020. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	5,907,467	5,448,318	5,402,833	5,425,954	6,295,234
Pagat dhe mëditjet	2,853,010	2,854,207	2,854,207	2,756,812	2,757,216
Mallrat dhe shërbimet	1,319,537	1,056,000	1,029,805	772,286	1,391,945
Komunalitë	102,370	102,370	84,064	54,272	98,721
Investimet Kapitale	1,632,550	1,435,740	1,434,757	1,842,583	2,047,352

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar më buxhetin fillestar ishte rritur për me vendim të qeverisë 1,198€. Shpenzimet në këtë kategori ishin 100% e buxhetit final;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar më buxhetin fillestar ishte zvogëluar me vendim qeverisë për 263,537€. Shpenzimet në këtë kategori ishin 98% e buxhetit final;
- Buxheti final për shërbime komunale krahasuar më buxhetin fillestar nuk kishte ndryshime. Shpenzimet në këtë kategori ishin 82% e buxhetit final; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar më buxhetin fillestar ishte zvogëluar me vendim të qeverisë për 196,810€. Shpenzimet në këtë kategori ishin 100% e buxhetit final.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga ASHNA në vitin 2021 ishin në vlerë 4,645,232€. Ato kanë të bëjnë me shërbimet terminale apo dhënies së shërbimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	0	0	4,645,232	2,472,980	4,518,808
Të hyrat jo tatimore	0	0	4,645,232	2,472,980	4,518,808

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të ASHNA ka rezultuar në dy rekomandime kryesore. ASHNA kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, një rekomandim është zbatuar, ndërsa për një rekomandim nuk ka filluar zbatimi. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasuritë	Drejtori duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë janë të regjistruara në regjistrat përkatës, në mënyrë që prezantimii tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.	ASHNA kishte regjistruar pasurinë kapitale në SIMFK.	I zbatuar
2.	Obligimet e papaguara	Drejtori duhet të siguroj funksionimin efikas të pikës së kontrollit që verifikon se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me ligj si dhe të prezantohen drejtë në raportin e obligimeve mujore në MF	Edhe këtë vit kishte vonesa në pagesën e faturave.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Naser Arllati, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Astrit Bllaca, Udhëheqës i ekipit



Albana Kadriu, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agjencia za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

REPUBLICA E KOSOVES		AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR	
REPUBLICA KOSOVO		AGENCIJA ZA VAZDUŠNO NAVIGACIJSKE USLUGE	
REPUBLIC OF KOSOVO		AIR NAVIGATION SERVICES AGENCY	
ZYRA E KOMBËTARE KANCELARIJA REVIZIJE CROCHIFFS OFFICE			
Nr. fac:	09	05 05 22	
Bil. tit:		Date:	
Pig. no:			
Nr. prot:	0203	N.T	LIPJAN, RKS
Bil. prot:			
Prot. no:			

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Samir Bllacaku

Drejtor i Përgjithshëm i ASHNA,

Data: 05.05.2022, Prishtinë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.